

VENDIM
Nr. 180, datë 7.8.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, nenit 39, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1924/5 prot., datë 1.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1924 prot., datë 23.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 135, datë 7.7.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.7.2025 dhe 9.7.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.7.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1924/3 prot., datë 16.7.2025, dhe me *e-mailin* e datës 22.7.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Me *e-mailin* e dërguar në të njëjtën ditë, shoqëria ka përditësuar adresën e saj dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1924/4 prot., datë 30.7.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti